

## **Trajnimi i përdoruesve të preparateve për mbrojtjen e bimëve – përgjigjet në pyetjet më të shpeshta**

### **1. A do të ketë njoftime përmes mjeteve të informimit rreth afateve të trajnimeve dhe në cilën komunë do të mbahen trajnimet?**

Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe Drejtoria për siguri të ushqimit, veterinari dhe çështje fitosanitare në një njoftim të dytë dhe me kohë do të njoftojë përmes mjeteve të informimit (gazetave, televizioneve, faqeve të internetit dhe mjeteve tjera të informimit) opinionin e interesuar dhe aplikantët rreth afateve të trajnimit, kurse dinamika e trajnimeve të cilat do të zhvillohen sipas regjioneve (Tivar, Podgoricë, Herceg Novi, Cetinë, Nikshiq, Bijello Pole dhe Beran) dhe numri i tyre do të harmonizohen në bazë të numrit të kërkesave (aplikimeve).

### **2. A pagohet tarifa e regjistrimit apo trajnimet janë falas?**

Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural e ka bërë të mundur që trajnimi i përdoruesve të preparateve për mbrojtjen e bimëve të mos paguhet nga prodhuesit bujqësorë.

Prodhuesit bujqësorë krahas aplikimit për trajnim paguajnë një taksë shumë të vogël prej 5€ të shoqëruar me kërkesën për lëshimin e kartës me çka pjesërisht mbulohen shpenzimet e lëshimit të saj, derisa trajnimi është plotësisht falas.

### **3. A është i paraparë testimi apo ndonjë formë tjetër e kontrollimit të njohurive?**

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit do të kenë një kontrollim të njohurive në formë të një testi të thjeshtë me rrumbullaksime.

### **4. A është i nevojshëm dokumentacion shtesë apo kërkesë për lëshimin e certifikatës?**

Po, është e nevojshme që formulari i plotësuar të shoqërohet me një kopje të letërnjoftimit dhe me një vërtetim të pagesës së taksës në vlerë prej 5,00 €, kurse dokumentacioni mund të dorëzohet me postë ose personalisht:

1. në zyrat rajonale të Shërbimit këshillimor për prodhimtarinë bimore në Tivar, Herceg Novi, Cetinë, Nikshiq, Podgoricë Bijello Pole dhe Beran; ose
2. në arkivin e Drejtorisë për sigurinë e ushqimit, veterinari dhe çështje fitosanitare, ul. Serdara Jola Piletića br. 26, 81000 Podgorica; ose
3. me postë elektronike në e-mail-in: [upravazabebjednosthrane@ubh.gov.me](mailto:upravazabebjednosthrane@ubh.gov.me); ose
4. me faks: 020 621 008; 020 201 946.

Telefonat kontaktues: 020 201 945; 020 621 111.

### **5. A duhet që aplikanti të ketë amvisëri bujqësore në emër të vet?**

Ky sistem është i projektuar në atë mënyrë që kushdo që përdor preparate për mbrojtjen e bimëve dhe që dëshiron t'i blejë ato duhet të jetë i trajnuar për përdorimin e tyre, sepse

përdorues të preparateve për mbrojtjen e bimëve nuk janë vetëm amvisëritë bujqësore, por edhe posedues tjerë të bimëve (ndërmarrja hekurudhore, ndërmarrjet komunale, pronarët e bimëve rreth shtëpive, në kopshte dhe në sipërfaqe tjera të cilat nuk i përkasin kategorisë së amvisërive bujqësore).

#### **6. A paguhet certifikata dhe sa kohë pritet për certifikatë?**

Lëshimi i certifikatës nuk paguhet, ajo është një dokument i cili lëshohet menjëherë pas përfundimit të trajnimit dhe shërben për lëshimin e kartës jo më vonë se 20 ditë pas përfundimit me sukses të kursit dhe ajo mund të merret edhe në zyrat rajonale të Shërbimit këshillimor për prodhimtarinë bimore në Tivar, Podgoricë, Herceg Novi, Cetinë, Nikshiq, Bijello Pole dhe Beran.

#### **7. Kur hyn në fuqi zbatimi i kësaj certifikate, gjegjësisht deri kur mund të blihen preparatet pa certifikatë?**

Pasi që t'u mundësohet të gjithë personave të interesuar që të kalojnë programin e trajnimit dhe pas analizës së të dhënave për numrin e personave që e kanë kryer trajnimin, Ministria do të sjell vendimin mbi datën e ndalimit të shitjes së preparateve për mbrojtjen e bimëve në pikat e shitjes me pakicë personave të cilët nuk posedojnë kartën.